



## **Njoftim: Mundësi Internship-i për marketing dhe promocion**

### **Kush jemi ne?**

EasyPay operon me një platformë pagesash dhe transfertash nga celulari dhe online. Përbëhet nga një skuadër e re, entuziaste dhe shumë të pasionuar për të ndryshuar mënyrën si behën pagesat në Shqipëri. EasyPay është institucioni i parë i parësë elektronike në Shqipëri, është vlerësuar me cmimin Bleta e Artë 2014 në kategorinë ICT, dhënë nga Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë dhe së fundmi është nominuar në European FinTech Awards si një nga 100 kompanitë më të mira financiare teknologjike në Europë.

### **Prezantim i shkurtër i punës:**

Po kërkojmë kandidatë entuziastë për t'ju bashkuar departamentit tonë të marketingut, me fokus promocionin në terren, mbledhjen dhe përpilimin e të dhënave pas cdo fushate.

Si intern i EasyPay, ju do të bashkëpunoni me departamentin e marketingut dhe jo vetëm, gjatë trajnimit fillestar si dhe në të gjitha hapat e fushatave. Kontributi juaj do të na ndihmojë të zhvillojmë, zgjerojmë dhe mirëmbajmë kanalin tone të marketingut offline.

Ky internship do t'ju lejojë të përvetësoni aftësi marketing dhe t'ju japë njohuri për strategji të ndryshme që përdoren. Ju do të përfitoni një eksperiencë të gjerë e cila do t'ju pergatisë për të hyrë më vonë në cfarëdo lloj ambienti pune me ritme të larta dhe do të ketë vlerë të madhe në CV-në tuaj.

### **Përgjegjësitë:**

- Shpërndarja e broshurave dhe materialeve promocionale sipas fushatave dhe zonave
- Prezantimi i shërbimeve të EasyPay dhe arritja e target-eve ditore për regjistrim klientësh në aplikacion
- Mbledhja e të dhënave kuantitative dhe kualitative nga fushatat e marketing
- Analizë e tregut dhe propozimi i strategjive efikase në bazë të lëvizjeve në terren
- Dhënia e mbështetjes për detyra administrative ditore në departamentin marketing
- Asistimi dhe pjesëmarrja në evente dhe aktivitete rinore e promocionale

### **Kualifikimet/Kërkesat:**

- Dëshirë të madhe për të zgjeruar dijet në fushen e marketing dhe për të mësuar në një nga kompanitë më inovatore në Europe
- Aftësi komunikimi verbale të shkëlqyera
- Njohuri të paketës bazë MS Office
- Eksperiencë të ngjashme në kompani reklamash apo në sektorin e shërbimeve
- Personalitet social, i/e përgjegjshme dhe bashkëpunues/e
- Ndjekës/e i trendeve të fundit rinore dhe digjitale
- Të jetë i/e përfshirë në një degë studimi relevante (Bachelor apo Master)

*Të interesuarit duhet të dërgojnë një CV në [marketing@easypay.al](mailto:marketing@easypay.al). Do të lajmërohen për intervistë vetëm kandidatët e përzgjedhur të cilëve mund t'u kërkohet dokumentacion shtesë.*

